

Tregtia me Pakicë

Tremujori IV, 2015


Tiranë, më 31 Mars: Në tremujorin e katërt 2015, indeksi i volumit të shitjeve në Tregtinë me Pakicë është rritur 6,8 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Ndërkaq, në grupin e Tregtisë me Pakicë pa përfshirë këtu Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve ky indeks ka pësuar një rritje prej 13,5 % kundrejt të njëjtit tremujor të vitit të mëparshëm.

Në këtë tremujor, në grupin “Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara”, indeksi i volumit të shitjeve është rritur 20,5 % krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2014, duke dhënë edhe në këtë tremujor kontributin kryesor në indeksin e volumit të shitjeve në Tregtinë me Pakicë.

Indeksi i volumit të shitjeve në Tregtinë me Pakicë për grupin e “Produkteve jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara (përfshirë Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)”, është rritur në nivelin 10,2 % kundrejt të njëjtës periudhë të vitit paraardhës.

Në tremujorin e katërt 2015, në grupin “Tregti Hidrokarburesh në njësi tregtare të specializuara”, indeksi i volumit të shitjeve është ulur 4,7 % krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2014, dhe 13,2 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Fig. 1 Indekset e volumit në Tregtinë me Pakicë dhe Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve




Ndikimi i nëngrupeve kryesore në indeksin e volumit të shitjeve në Tregtisë me Pakicë

Indeksi i volumit të shitjeve në Tregtinë me Pakicë në tremujorin e katërt 2015 krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2014 është rritur 6,8* përqind, i ndikuar nga nëngrupet: nëngrupi “Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara” +4,5 pikë përqindje, duke dhënë në këtë tremujor ndikimin më të madh në indeksin e volumit të shitjeve në Tregtinë me Pakicë; nëngrupi “Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure” +1,8 pikë përqindje; nëngrupi “Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjienës personale” +1,4 pikë përqindje; nëngrupi “Artikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura” +1,0 pikë përqindje; nëngrupi “Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimit, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara” +0,3 pikë përqindje; nëngrupi “Pajisje kompjuterike, informatike dhe të komunikacionit” +0,2 pikë përqindje; dhe nëngrupi “Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara” +0,1 pikë përqindje.

Nëngrupi “Tregti me pakicë e Hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara” -1,6 pikë përqindje; nëngrupi “Pajisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake” -0,4 pikë përqindje dhe nëngrupi “Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare të specializuara” -0,3 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimet e nëngrupeve kryesore në Tregtinë me Pakicë




* Shuma e kontributeve prej 7 përqind është përafërsisht e barabartë me normën e rritjes vjetore prej 6,8 përqind. Kjo shumë nuk do të përkohet përpikmërisht me normën e rritjes aktuale për shkak se metodologjia e lidhjes zinxhir (*chain-link*) e përdorur për indeksin e agreguar nuk mundëson një zbrëthim të saktë linear.

Tab. 1 Ndryshimi vjetor i indeksit mesatar tremujor në Tregtinë me Pakicë dhe Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve

NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	IV.14 / IV.13	I.15 / I.14	II.15 / II.14	III.15 / III.14	IV.15 / IV.14
47	Tregti me Pakicë	4,1	3,3	3,4	7,8	6,8
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	7,1	7,1	6,2	15,1	13,5
4711	Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara	17,4	16,2	16,9	24,6	27,8
4719	Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara	-17,6	8,3	3,1	7,4	3,3
472	Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare të specializuara	-13,8	-15,8	-18,6	-6,6	-6,4
474	Pajisje kompjuterike, informatike dhe te komunikacionit	-0,7	-9,2	0,0	14,3	4,6
475	Pajisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake	9,0	-6,4	-4,1	9,3	-1,4
476	Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimit, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara	7,6	12,7	7,7	19,6	15,5
4771-4772	Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure	12,0	12,8	5,9	18,5	27,7
4773-4775	Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjenës personale	25,2	28,4	21,7	12,4	16,5
4776-4778	Artikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura	17,9	6,1	10,9	35,3	31,2
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	-0,8	-2,6	-0,7	-2,3	-4,7
4730	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	-0,8	-2,6	-0,7	-2,3	-4,7

Fig. 3 Ndryshimi vjetor i indeksit mesatar tremujor të nëngrupeve kryesore ushqimore dhe jo ushqimore në Tregtinë me Pakicë



Tab. 2 Ndryshimi tremujor i indeksit mesatar tremujor në Tregtinë me Pakicë dhe Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve

NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	IV.14 / III.14	I.15 / IV.14	II.15 / I.15	III.15 / II.15	IV.15 / III.15	%
47	Tregti me Pakicë	2,6	-13,2	6,9	13,2	1,6	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	12,5	-13,5	3,5	14,2	10,9	
4711	Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara	12,4	-7,9	9,8	9,6	15,3	
4719	Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara	5,7	7,9	-14,9	10,5	1,7	
472	Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare të specializuara	-3,8	-19,3	9,5	9,9	-3,5	
474	Pajisje kompjuterike, informatike dhe te komunikacionit	8,9	-9,7	11,3	4,4	-0,3	
475	Pajisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake	22,6	-37,4	8,4	31,5	10,6	
476	Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimit, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara	12,6	-30,3	12,7	35,3	8,7	
4771-4772	Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure	7,6	5,3	-7,6	13,2	16,0	
4773-4775	Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjenës personale	9,7	3,9	-2,1	0,8	13,7	
4776-4778	Artikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura	6,1	11,3	0,2	14,3	2,9	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	-11,0	-12,7	12,8	11,6	-13,2	
4730	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	-11,0	-12,7	12,8	11,6	-13,2	

Tab. 3 Ndryshimi vjetor i indeksit mujor në Tregtinë me Pakicë dhe Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve

NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	10-15 / 10-14	11-15 / 11-14	12-15 / 12-14	%
47	Tregti me Pakicë	4,6	8,0	7,5	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	10,9	12,0	16,7	
4711	Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara	22,4	23,5	35,4	
4719	Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara	5,9	1,6	2,7	
472	Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare të specializuara	-7,6	-4,5	-7,1	
474	Pajisje kompjuterike, informatike dhe te komunikacionit	20,2	21,4	-15,5	
475	Pajisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake	-9,5	-5,9	8,5	
476	Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimit, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara	14,2	-7,2	37,3	
4771-4772	Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure	27,3	37,6	20,7	
4773-4775	Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjenës personale	13,9	19,7	16,1	
4776-4778	Artikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura	43,4	29,3	23,5	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	-5,8	1,2	-8,4	
4730	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	-5,8	1,2	-8,4	

Tab. 4 Ndryshimi mujor i indeksit mujor në Tregtinë me Pakicë dhe Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve

NVE Rev.2		Aktiviteti Ekonomik	10-15 / 09-15	11-15 / 10-15	12-15 / 11-15
47	Tregti me Pakicë		-9,1	0,9	23,7
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)		-10,0	0,4	29,7
4711	Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara		-7,6	0,2	41,2
4719	Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara		-13,9	9,2	13,2
472	Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare të specializuara		-0,1	5,6	-8,4
474	Pajisje kompjuterike, informatike dhe te komunikacionit		-7,1	-7,6	17,3
475	Paisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake		-21,7	5,8	46,5
476	Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimit, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara		-12,8	-17,7	61,9
4771-4772	Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure		-0,1	-6,0	21,6
4773-4775	Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjenes personale		0,1	1,9	0,9
4776-4778	Artikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura		-15,2	-2,2	17,4
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara		-7,3	2,0	12,1
4730	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara		-7,3	2,0	12,1

Tab. 5 Indekset mujore në vlerë dhe volum në Tregtinë me Pakicë

2010=100

NVE Rev.2		Grup 47							
Viti	2012		2013		2014		2015		
Muaji	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	
1	104,8	94,6	119,2	105,4	128,9	111,5	128,7	118,5	
2	100,6	89,9	115,7	101,7	126,5	109,5	124,4	111,5	
3	115,4	101,7	128,9	113,2	135,9	117,5	135,5	119,7	
4	115,7	102,1	128,3	112,8	132,0	115,0	134,7	118,7	
5	117,9	105,5	131,8	116,4	138,5	121,4	141,2	125,2	
6	123,8	112,1	132,8	118,0	142,3	125,2	146,5	130,0	
7	129,4	116,0	136,1	124,7	145,1	128,2	148,6	131,9	
8	144,7	128,0	142,3	127,0	154,7	136,2	163,8	146,1	
9	135,0	118,7	131,7	117,3	145,5	128,1	162,4	145,1	
10	131,2	115,8	137,7	122,4	142,7	126,2	147,4	132,0	
11	121,7	107,4	138,2	123,4	138,6	123,3	147,1	133,2	
12	166,8	147,3	159,1	141,0	168,4	153,3	182,6	164,8	

Tab. 6 Indekset mujore në vlerë dhe volum në Tregtinë me Pakicë të Hidrokarbureve

2010=100

NVE		Grup 4730							
Viti	2012		2013		2014		2015		
Muaji	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	
1	163,2	130,0	187,4	146,4	200,5	155,1	184,5	163,0	
2	141,8	111,0	169,9	132,1	193,4	146,2	164,6	141,0	
3	177,9	135,2	187,9	146,9	205,7	156,0	170,6	141,6	
4	181,7	138,1	202,8	157,8	205,7	157,1	188,6	153,6	
5	176,5	137,0	210,1	163,5	222,5	170,2	214,9	173,7	
6	194,8	155,2	210,8	165,1	233,3	178,8	220,9	175,2	
7	219	171,6	213,4	178,1	238,2	182,4	233,4	183,7	
8	275,4	211,8	237,2	185,3	276,2	211,3	262,8	211,0	
9	238,2	180,2	205,2	160,8	235,0	179,8	201,2	165,8	
10	226,2	172,7	216,0	169,3	211,4	163,3	185,6	153,7	
11	206,8	158,3	207,0	163,1	197,3	154,9	183,7	156,8	
12	244,3	187,3	230,4	181,8	227,1	192,0	202,8	175,8	

Metodologjia

Informacion

Në vazhden e përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave të tregtisë me pakicë me statistikat evropiane, INSTAT po publikon Indeks të vëllimit në tregtinë me pakicë me disa ndryshime metodologjike, si:

- Aplikimi i Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve ekonomike, NVE rev.2;
- Ri-referimi, përditësohet periudha referuese nga 2005=100 në 2010=100;

Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE rev.2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.

Për më shumë shikoni linkun: http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim_per_media_-_ndryshimi_i_nomenklatur_s_s_veprimtarive_ekonomike_rev_2.pdf

Klasifikimi i rishikuar është në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm nga klasifikimi ekzistues në drejtim të strukturës, klasifikimit dhe trajtimit metodologjik të disa aktiviteteve.

Kalimi i njësive statistikore nga NVE rev.1.1 në NVE rev.2 është bërë nëpërmjet ndërtimit të matricës së konvertuar, bazuar në informacionin statistikor të përfutur nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2010.

Referuar pikërisht kësaj matrice ndryshimet që sjellë klasifikimi i ri për tregtinë me pakicë janë si më poshtë:

1. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) "Tregtia me pakicë", përkon me ndarjen 52, ku përfshihen të gjithë grupet nga 5211-5248. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) "Tregtia me pakicë" përkon me ndarjen 47, ku përfshihen grupet 4711-4799. Pjesë e këtij grupimi është edhe grupi 473 "Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara", çka përbënë risi, duke u bërë pjesë kësaj në llogaritjet në indeksin e tregtisë me pakicë.
2. Një tjetër risi e klasifikimit të ri, me ndikim në publikimin e indeksit të tregtisë me pakicë është edhe largimi nga formati i publikimit të indeksit të "Tregtimit dhe riparimit të automjeteve". Me klasifikimin e vjetër ndarja 50.1-50.4 "Tregtim dhe riparim i automjeteve", e cila me klasifikimin e ri përkon me ndarjen 45, bëhet pjesë e formatit të publikimit të tregtisë me shumicë.
3. Së fundmi, kemi detajimin me grupit 5248 "Tregti me pakicë e produkteve industriale në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në asnjë grup tjetër", sipas grupimit me NVE Rev.1, në disa grupime të tjera, sipas klasifikimit në NVE Rev.2, si për shembull 474- Pajisje kompjuterike, informatike dhe të komunikacionit, 476- Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimit, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe

të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara dhe 4776-4778 - Tregti me pakicë e produkteve industriale në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në asnjë grup tjetër”

Treguesi kryesor i shifrës së afarizmit është përdorur për rivlerësimin e kalimit të aktiviteteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re. Metodatat kryesore të përdorura për vlerësim janë dy:

-Metoda e vlerësimit në nivel mikro

-Metoda e vlerësimit në nivel makro

Metoda e parë, u përdor për tre vitet e para të riklasifikimit të aktiviteteve të njëjësive në nivel individual në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2010-2012;

Metoda e dytë, u përdor për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore pas, për periudhën 2005-2010.

Ri –referim, shprehimisht do të thotë kalimi i indekseve me një periudhe referuese të re, nga 2005=100 në 2010=100. Seritë e të dhënave, të llogaritura me të dy periudhat, janë ekuivalente me njëra-tjetrën: ritmet e rritjes janë të njëjta, dhe një seri mund të konvertohet tek tjetra.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat tremujore të Tregtisë me pakicë pranë ndërmarrjeve tregtare përshkruajnë ecurinë dhe zhvillimet më të fundit të treguesve ekonomik në njësitë e shitjes me pakicë dhe konsumit të popullatës në vend.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor janë përfshirë në vrojtim:

- ndërmarrjet e tregtisë me pakicë grupi 47-NVE Rev.2 (përfshijto 47.79-4799)
- tregtia me pakicë e hidrokarbureve grupi 473-NVE Rev. 2

Grupet janë vlerësuar në bazë të përqindjes që secili produkt ose mall ka zenë në shifrën gjithsej të afarizmit të realizuar nga ndërmarrjet. Për kodifikimin e produkteve është përdorur Nomenklatura e Produkteve (NP). Grupet kryesore të detajimit janë në përputhje me grupet përkuese në Indeksin e Çmimeve të Konsumit. Indekset krahasohen me periudhën bazë, 2010=100.

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 4 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 5 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Nga të dhënat mblidhen direkt nga ndërmarrjet me anketues të cilët plotësojnë pyetësonin Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve të Tregtisë.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi tremujor në përqindje, ndryshimi vjetor në përqindje me një vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indeksin e çmimeve të konsumit për periudhat përkatëse sipas grupeve përkuese.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizim i treguesit kryesor - Shifra e afarizmit përfshin shitjet mujore gjithsej që ndërmarrja realizon gjatë muajit nga shitja e produkteve apo shërbimeve përjashtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).